



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:041184

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05646314

PKR.nr.84/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Naser Foniqi – në vijim KTGJ, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarve O.K. e A.E., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.27/2024, të datës 15.04.2024, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 25.04.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Dulina Hamiti dhe të akuzuarit O.K. me mbrojtësen e tij av. Arlinda Haziri me autorizim dhe A.E. me mbrojtësen e tij av. Sahadete Gashi me autorizim, me datë 25.04.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

O.K., i biri i M. dhe M., e vajzërisë Q., i lindur me datë ... në Prishtinë, lagja ..., rr. "...", ndërtesa ..., objekti ..., hyrja ..., numër ..., me numër personal ..., student në fakultetin dizajn interior, i pa martuar, i punësuar - realizon pagë mujore me shumë prej 500 euro, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, dhe

A.E., i biri i F. dhe S., e vajzërisë B., i lindur me datë ... në fshatin G., Komuna Podujevë, me banim në Prishtinë, rr. "...", numër ..., me numër personal ..., ka të kryer fakultetin e biznesit ndërkombëtar, i pa martuar, i punësuar - realizon pagë mujore në shumë prej 1450 euro, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTORË

S e p s e: me datë 02.02.2024 rreth orës 20:40, në Prishtinë, në Lagjen ..., në Rr. "...", të akuzuarit O.K. dhe A.E., në bashkëkryerje kanë poseduar pa autorizim substanca narkotike, psikotrope dhe analoge të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, ashtu që gjatë kontrollit nga policia - Njësia DHTN- në Prishtinë, derisa të akuzuarit si më lart kanë qenë së bashku në veturën me targa ..., gjatë kontrollit nga policia iu është gjetur dhe sekuestruar një qese e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë 1.2 gram, të cilën e kishin blerë së bashku me qëllim që ta konsumojnë,-

- me këto veprime, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 38; 43; 69 dhe 269, par. 2 dhe 3 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarve O.K. e A.E. iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- **Në shumë prej tetëqind (800) € secilit veç e veç**, e i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Dënimi me gjobë si më lart, të akuzuarit mund ta paguajnë deri në tre këste.
- Obligohen të akuzuarit, që secili veç e veç t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, **ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej njëqind (100) € dhe nga pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarve si më lart, iu konfiskohet dhe shkatërrohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 1.2 gram, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria për hetimin e trafikimit me narkotik, nr. R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-21, të datës 03.02.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.27/2024, të datës 15.04.2024, ka akuzuar të pandehurit: L.Xh. e E.H., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK; O.K. e A.E., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe L.Xh. edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, gjykata e ka kthyer të njëjtën në plotësim dhe precizim, ndërsa prokurori i shtetit ka bërë plotësimin dhe precizimin e saj por nuk ka ndryshuar përmbajtjen e dispozitivëve të aktakuzës, përveç renditjes së përshkrimit të veprimeve të akuzuarve.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 25.04.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit O.K. dhe A.E. kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar, si dhe kanë shtuar se janë të vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe këtë pranim e kanë bërë vullnetarisht. Pastaj, i akuzuari O.K. ka thënë se qesja prej 1.2 gram më substancë narkotike marihuanë është gjetur te ai, të njëjtën e ka pasur në xhep kur nga ai e ka sekuestruar policia, dhe se e ka pasur për konsumim personal, duke theksuar se ndjen keqardhje për atë që ka ndodhur, se ka qenë hera e parë dhe ka premtuar se nuk do të ndodh më. Pastaj, i akuzuari Krasniqi ka thënë se nuk ka raste të tjera të hapura në gjykatë dhe ka kërkuar nga gjykata që atij t'i shqiptoj një dënim më të butë. Ndërsa, i akuzuari A.E. ka thënë se qesja prej 1.2 gram më substancë narkotike marihuanë

është gjetur te shoku i tij O.K. dhe se këtë qese e kanë blerë bashkë dhe kanë pasur për qëllim që ta konsumojnë së bashku, përkatësisht ta provojnë këtë substancë, duke shtuar se ndjen keqardhje për atë që ka ndodhur, se ka qenë hera e parë, si dhe ka premtuar se nuk do të ndodhë më. Pastaj, i akuzuari E. ka thënë se nuk ka raste të tjera të hapura në gjykatë dhe ka kërkuar nga gjykata që atij t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pasi që ky pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është në përputhshmëri të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj një pranim të tillë.

Mbrojtësja të akuzuarit O.K., av. Arlinda Haziri ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i saj është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme më të si mbrojtëse, pasi i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj i ka propozuar gjykatës që ta bëjë aprovimin e pranimit të fajësisë dhe ndaj të mbrojturit të saj të veçohet procedura, me qëllim të përfundimit në kohë të arsyeshme të procedurës ndaj tij.

Edhe mbrojtësja e të akuzuarit A.E., av. Sahadete Gashi ka thënë se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i saj është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme më të si mbrojtëse, pasi i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj i ka propozuar gjykatës që ta bëjë aprovimin e pranimit të fajësisë dhe ndaj të mbrojturit të saj të veçohet procedura, me qëllim të përfundimit në kohë të arsyeshme të procedurës ndaj tij.

Pas deklarimit të akuzuarve, prokurorit të shtetit dhe mbrojtëseve të akuzuarve K.e E., KTGJ me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se ky pranim nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimit apo premtimit si dhe është mbështetur në faktet që përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse të akuzuarit O.K. e A.E. e kanë pranuar fajësinë, për arsye të efikasitetit të përfundimit të procedurës penale ndaj këtyre të akuzuarve, përkatësisht me qëllim të një gjykimi të drejtë dhe në një afat sa më të shkurtër të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi dhe Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, gjykata ka vendosur ta veçoj procedurën penale ndaj të akuzuarve si më lart.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës përkatësisht: vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve DKKO/DHTN, nr. R-2023-XI-DKKO-HTN-PR-21, të datës 02.02.2024 dhe foto albumi në të cilin shihen fotot e substancës narkotike të sekuestruar, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe i shpalli fajtorë të akuzuarit, pasi që më parë gjeti se janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarve gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim: intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht nuk kemi ndonjë lloj dëmi të shkaktuar; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajit për veprën e kryer penale dhe sipas të dhënave nga evidencat penale të njëjtit më parë nuk kanë qenë të dënuar ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë

veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarve i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me dënimin e shqiptuar atyre, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36, par. 3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi që të akuzuarve t'i konfiskohet sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 269 par. 3 të KPRK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 269, par. 2 dhe 3 të KPRK, si dhe nenit 364 Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 02.05.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.84/2024, datë 25.04.2024.

Bashkëpunëtoresh profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh** nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.